



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 13.09.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 10.09.2024, të parashtruar nga Operatori ekonomik **Pro & Co Group SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Zgjerimi dhe rregullimi i rrugës Tranziti i qytetit**”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-8521-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-104-521, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim të Operatori Ekonomik “**Pro & Co Group SH.P.K.**”, e dt.10.09.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Zgjerimi dhe rregullimi i rrugës Tranziti i qytetit**”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-8521-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-104-521, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të datës 23.08.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË**, i publikuar me datë: 23.08.2024;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik “**Pro & Co Group SH.P.K.**”, me dt.10.09.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Zgjerimi dhe rregullimi i rrugës Tranziti i qytetit**”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-8521-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-104-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 13.09.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet e juaja nuk qëndrojnë sepse Autoriteti kontraktues Komuna e Gjakovës ka vepruar në harmoni të plotë me nenin 7 dhe 28 të LPP-së, pasi që të gjitha pajisjet e kërkuara përmes dosjes së tenderit janë të domosdoshme për kryerjen sa më efikase dhe më të shpejtë të shërbimeve-punëve të kërkuara.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit
